



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.08/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj V.F, Gjyqtare pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtrri, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala B.A, nga Komuna e Vushtrrisë, pas vlerësimit të kërkesës-ankesës së parashtruar nga pala B.A dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtares V.F, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 22.08.2023, merre këtë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.08.08.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.08/2023, e parashtruar nga pala B.A nga Vushtrria rr.”...”, kundër Gjyqtares V.F, Gjyqtare prane Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri Divizioni Civil, e **PA BAZUAR**.

A r s y e t i m

Në cilësinë e autoritetit kompetent të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ne rrethanat aktuale, me dt.08.08.2023 kemi pranuar ankesën nga B.A nga Vushtrria rr. “...”, e cila ankese fillimisht i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kundër Gjyqtares V.F, Gjyqtare në Gjykatës Themelore në Mitrovicë– Dega Vushtrri.

Pala ankuese B.A me ankesë se i është drejtuar Këshillit Gjyqësor te Kosovës lidhur me veprimet e gjyqtares V.F, ne te cilën ankesa ka theksuar se e njejta ka mbajtur dy seanca dhe i ka jep të drejt një familje tjetër te cilën ne ankese e ka cilësuar si dhunuese, ka theksuar edhe rrethana te tjera duke përfshirë rrethana qe nga viti 2004, e ne vazhdim, rrethana qe i përkasin te njëjtit e nuk ka te bëjnë me rastin konkret te trajtuar nga gjyqtarja siç konstatohen ne përmbajtjen e ankesës.

Autoriteti kompetent në rastin konkret ka marrë veprime procedurale pas pranimit të ankesës, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj subjektit të hetimit-gjyqtares e cila ka dhënë deklaratë me shkrim lidhur me ankesën e B.A, ka theksuar se B.A në seancë ka prezantuar vetëm si baba i M.A, e cila është palë në lëndën C.nr.544/23, për të cilën lëndë ka vendosur me aktvendim me dt.05.06.2023, të cilin vendim e kanë pranuar të gjitha palët në procedurë dhe ndaj të njëjtit vendim nuk është paraqitur asnjë ankese, si rrjedhojë vendim është i plotfuqishëm.

Në ankesën e parashtruar nga ankuesi B.A ka vërejtur se vetëm paragrafi i parë i ankesës i referohet tërthorazi lëndës të cilës i ka dhënë epilog përfundimtar, ndërsa pjesa tjetër i referohet situatave të cilat janë të pa njohura për të. Ankuesi B.A nuk ka qenë palë në procedure civile, nuk i ka dërguar thirrje për seancë dhe nuk është proceduar si palë në procedurë. Nuk qëndrojnë pretendimet se e ka ofenduar këtë person apo këdo qofte tjetër.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësi disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror janë të pa qëndrueshme, nuk kemi asnjë dyshimi të qëndrueshëm për veprimet procedurale në raport me subjektin e hetimit duke marrë për

bazë përgjigjen e marrë nga gjyqtarja ndaj të cilës është ngritur procedura disiplinore, e cila në mënyrë përmbajtjesore i ka shpjeguar veprimet e ndërmarra, duke cek se ankuesi nuk ka qenë palë e as subjekt në procedurë civile, por në seancë ka prezantuar vetëm si babai i M.A, e cila është palë në çështjen juridike civile C.nr.544/23 të cilën lëndën e ka vendosur me aktvendimin e datës 05.06.2023, të cilin vendim të gjitha palët e kanë pranuar dhe nuk është paraqitur ankesë dhe si rrjedhojë vendim është bërë plotfuqishëm, në rastin konkret parashtruesi i ankesën nuk është palë në procedurë, në një situatë të tillë nuk kemi shkelje disiplinore dhe ankesa si e tille është refuzuar si e pabazuar me arsyet sic theksohen me larte.

Autoriteti kompetent vlerëson se pakënaqësitë e palëve të marrja e vendimit, nuk mund të konsiderohet edhe shkelje disiplinoren ne këtë rast palët e kane pasur te drejtën ligjore te parashtrimit te ankese kundër aktvendimit ne afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit te aktvendimit e drejte cila nuk është shfrytëzuar nga ana e palëve te procedurës dhe nga rrethanat nuk rrjedh se kemi te bëjmë me shkelje ligjore disiplinore ne rastin konkret.

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinorë te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullore për Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
AD.GJTHM.nr.8/2023, dt.22.08.2023

Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit te ankesës B.A**
- 3. Gjyqtares V.F**